

Në bazë të nenit 10 dhe nenit 15 paragrafi (3) i Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke vepruar sipas Njoftimit për ndarjen e planifikuar të ndihmës dhe Njoftimit për informacione shtesë për formularin e njoftimit për ndihmën rajonale nr. 10-73 të datës 05.05.2023, të dorëzuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhënës i ndihmës shtetërore, e përfaqësuar nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial, për ndarjen e ndihmës rajonale të planifikuar ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, në seancën e mbajtur më 26.05.2023, miratoi

AKTVENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë shqyrtimit të Njoftimit për ndarjen e planifikuar të ndihmës dhe Njoftimit për informacione shtesë për formularin e njoftimit për ndihmën rajonale nr. 10-73 të datës 05.05.2023, të dorëzuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhënës i ndihmës shtetërore, e përfaqësuar nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial, për ndarjen e ndihmës rajonale të planifikuar ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, si përfituese e ndihmës shtetërore, konstatoi se:

Masa

- **Ndihmë në formën e grantit ose formë tjetër të ndihmës shtetërore që do të nënkuptojë përdorimin e objektit me qira në kushte më të ulëta se çmimi i tregut në vlerë prej 35% të qirasë vjetore të ndërtesës për një periudhë deri në 10 vjet duke filluar nga data e fillimit, vetëm nëse pagesa e qirasë është bërë në kushte dhe çmim real të tregut të aplikueshëm për lizingun financiar të ndërtesës.**

përbën **ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe përbën **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore. Një masë e tillë e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore përbën **ndihmë rajonale si ndihmë individuale sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, ku dhënia e saj është e lejuar.**

Dhënësi i ndihmës shtetërore dhe përfituesi i ndihmës shtetërore pajtohen dhe pranojnë se për realizimin e projektit investues, përfituesit të ndihmës shtetërore i lejohet të lidhë një marrëveshje për lizing financiar të një ndërtese në zonë, ku përfituesi i ndihmës shtetërore do të bëhet pronar i ndërtesës në fund të lizingut dhe me kryerjen e pagesës së fundit vjetore të lizingut, për shkak të së cilës e gjithë vlera e ndërtesës do të shpërndahet në pagesa të tilla vjetore qiraje; ose një marrëveshje qiraje për qëllime të fitimit të pronësisë së një ndërtese në zonë, ku përfituesi i ndihmës shtetërore do të marrë me qira ndërtesën dhe do të paguajë qira vjetore, me të drejtë (opcion blerjeje) dhe detyrim që përfituesi i ndihmës shtetërore të blejë ndërtesën nga pronari në fund të periudhës së qirasë ose më herët, duke paguar një shumë blerjeje të rënë dakord paraprakisht.

Pagesa vjetore e qirasë për marrëveshjen e lizingut financiar ose pagesa vjetore e qirasë dhe pagesa e blerjes në marrëveshjen e qirasë për qëllime të fitimit të pronësisë, pa marrë parasysh se cila do të jetë e aplikueshme, do të quhet "qira vjetore".

Masa

- Ndhimë në vlerë prej 10% të shumës së shpenzimeve investuese të justifikuara të realizuara deri në datën e përfundimit, e cila do të paguhet me këste si vijon:
- rata e parë në vlerë prej 436.118 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2024, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2024;
- rata e dytë në vlerë prej 287.064 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2025, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2025;
- rata e tretë në vlerë prej 288.017 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2026, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2026;
- rata e katërt në vlerë prej 288.977 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2027, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2027;
- rata e pestë në vlerë prej 298.945 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2028, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2028;
- rata e gjashtë në vlerë prej 290.919 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2029, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2029;
- rata e shtatë në vlerë prej 291.901 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2030, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2030;
- rata e tetë në vlerë prej 292.890 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2031, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2031 dhe
- rata e nëntë në vlerë prej 243.887 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2032, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2032.
-

përbën ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe përbën **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore. Një masë e tillë e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore përbën **ndihmë rajonale si ndihmë individuale sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, ku dhënia e saj është e lejuar.**

Ndihma shtetërore për çdo kësht do të jetë 10% e shpenzimeve investuese të justifikuara të realizuara deri në datën e përfundimit.

Masa

- Ndhimë shtesë në vlerë prej 10% të shumës së shpenzimeve investuese të justifikuara të realizuara deri në datën e përfundimit, e cila do të paguhet me këste si vijon:

- rata e parë në vlerë prej 436.118 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2024, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2024, duke konfirmuar se në vitin 2023 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2020, 2021 dhe 2022);
- rata e dytë në vlerë prej 287.064 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2025, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2025, duke konfirmuar se në vitin 2024 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2021, 2022 dhe 2023);
- rata e tretë në vlerë prej 288.017 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2026, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2026, duke konfirmuar se në vitin 2025 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2022, 2023 dhe 2024);
- rata e katërt në vlerë prej 288.977 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2027, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2027, duke konfirmuar se në vitin 2026 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2023, 2024 dhe 2025);
- rata e pestë në vlerë prej 298.945 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2028, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2028, duke konfirmuar se në vitin 2027 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2024, 2025 dhe 2026);
- rata e gjashtë në vlerë prej 290.919 euro do të paguhet më së voni deri më 30.12.2029, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2029, duke konfirmuar se në vitin 2028 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2025, 2026 dhe 2027);
- rata e shtatë në vlerë prej 291.901 euro do të paguhet më së voni deri më 30.12.2030, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2030, duke konfirmuar se në vitin 2029 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2026, 2027 dhe 2028);
- rata e tetë në vlerë prej 292.890 euro do të paguhet më së voni deri më 30.12.2031, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2031, duke konfirmuar se në vitin 2030 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2027, 2028 dhe 2029) dhe
- rata e nëntë në vlerë prej 243.887 euro do të paguhet më së voni deri më 30.12.2032, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2032, duke konfirmuar se në vitin

2031 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2028, 2029 dhe 2030).

përbën ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe përbën **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore. Një masë e tillë e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore përbën **ndihmë rajonale si ndihmë individuale sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, ku dhënia e saj është e lejuar.**

Ndihma shtetërore për çdo kësht do të jetë 10% e shpenzimeve investuese të justifikuara të realizuara në periudhën deri në datën e përfundimit.

Masa

- **Ndihmë për krijimin e vendeve të reja të punës për punonjës të rinj, të punësuar me orar të plotë deri në datën e përfundimit të projektit investues, si vazhdim i numrit të punonjësve prej 350 punonjësve aktualisht të punësuar tek përfituesi i ndihmës shtetërore, në vlerë prej 3.000 euro për një vend pune në kundërvlerë denari sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e paraqitjes së kërkesës nga përfituesi i ndihmës shtetërore.**

përbën ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe përbën **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore. Një masë e tillë e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore përbën **ndihmë rajonale si ndihmë individuale sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, ku dhënia e saj është e lejuar.**

Ndihma shtetërore për krijimin e vendeve të reja të punës do të paguhet nga dhënësi i ndihmës shtetërore për përfituesin e ndihmës shtetërore për vendet e reja të punës të krijuara në periudhën deri në datën e përfundimit, vetëm nëse niveli dhe norma e rritjes së pagave bruto mujore bazë janë të barabarta ose tejkalojnë dinamikën e rritjes siç është projektuar në Planin e Biznesit nr. 13-205/4 të datës 09.11.2022.

Në përputhje me Planin e Biznesit, përfituesi i ndihmës shtetërore planifikon të investojë një shumë prej 29.546.095 euro si shpenzime investuese të justifikuara për projektin investues në zonë, në periudhën deri në datën e përfundimit të projektit investues, ku palët pajtohen se shuma realisht e investuar e shpenzimeve investuese të justifikuara të konfirmuara të realizuara deri në datën e përfundimit mund të jetë më e ulët ose më e lartë se shuma e planifikuar prej 29.546.095 euro.

Përfituesi i ndihmës do të mbajë investimin, pra asetet (objektet, ndërtesat, pajisjet) në zonë në gjendje produktive, operationale dhe të përdorshme për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh nga data e përfundimit të projektit investues, gjë që është në përputhje me nenin 6 (1) të Rregullores për Kushtet dhe Procedurën për Ndarjen e Ndhmës Rajonale. Nëse përfituesi i ndihmës shtetërore nuk e plotëson këtë kusht, ai është i detyruar të kthejë shumën e plotë të ndihmës shtetërore të marrë sipas Marrëveshjes për Ndarjen e Ndhmës Shtetërore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup së bashku me normën e interesit të llogaritur në përputhje me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore dhe bazuar në normën referencë për

llogaritjen e normës së interesit të publikuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përfituesi i ndihmës shtetërore do të financojë të paktën 25% të shpenzimeve investuese të justifikuara për projektin investues nga burime vetjake ose nga një palë e tretë në një formë që nuk përbën ndihmë shtetërore sipas Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.

Përfituesi i ndihmës shtetërore do të sigurojë të gjitha asetet për realizimin e projektit investues në zonë nga rreziqet që rrjedhin nga operacionet. Përfituesi i ndihmës shtetërore do të sigurojë asetet që janë objekt i ndihmës shtetërore për kohëzgjatjen e projektit investues dhe 5 vjet pas datës së përfundimit të projektit investues.

Përfituesi i ndihmës shtetërore do të mbajë të paktën nivelin aktual të operacioneve në prodhim dhe/ose të paktën nivelin aktual të detyrimeve tatimore në bazë vjetore. Përfituesi i ndihmës shtetërore detyrohet të mos zvogëlojë numrin e vendeve të punës të krijuara para realizimit të projektit investues në zonë për një periudhë kohore të barabartë me periudhën e qëndrueshmërisë së investimit të ri në ZZHTI Shkup 2.

Shoqëria Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup do të krijojë 53 vende të reja pune duke punësuar të paktën 53 punonjës të rinj deri në datën e përfundimit të projektit investues, me të cilët do të lidhë marrëveshje për nevojat e projektit investues duke filluar nga data e lëshimit të Vendimit për fillimin e punës si vazhdim i numrit të punonjësve mbi 350 aktualisht të punësuar nga përfituesi i ndihmës shtetërore.

Përfituesi i ndihmës shtetërore detyrohet të mbajë numrin total të vendeve të reja të punës për të cilat ka marrë ndihmë shtetërore në përputhje me nenin 7 të Propozim-Marrëveshjes për ndarjen e ndihmës shtetërore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e përfundimit të projektit investues.

Ndihma shtetërore rajonale kumulative për projektin investues do të kufizohet në një shumë jo më të lartë se 50% e shpenzimeve investuese të justifikuara të konfirmuara të realizuara deri në datën e përfundimit të projektit investues.

Ndarja e ndihmës shtetërore lejohet vetëm nëse, përveç investimit të ri të planifikuar në ZZHTI Shkup 2, kompania ruan investimin aktual dhe objektin e prodhimit së bashku me të gjithë punonjësit në të njëjtin vëllim si para periudhës së fillimit të investimit të planifikuar në ZZHTI Shkup 2 për një periudhë kohore të barabartë me periudhën e qëndrueshmërisë së investimit të ri të planifikuar në ZZHTI Shkup 2.

Arsyetim

Sipas nenit 10 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: KMK) është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme mbështetjeje, përkatësisht nëse ajo përbën apo jo ndihmë shtetërore në kuptim të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.

Çdo dhënës i ndihmës shtetërore, i përcaktuar në nenin 6 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, është i detyruar, sipas nenit 13 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, të dorëzojë tek KMK njoftim për çdo plan për ndarjen e ndihmës

shtetërore të re ose ndryshimin e ndihmës ekzistuese, pavarësisht nëse ajo ndahet si ndihmë individuale apo si skemë ndihme.

Duke vepruar në përputhje me detyrimin e njoftimit në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhënës i ndihmës shtetërore, Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial dorëzoi Njoftimin për ndarjen e planifikuar të ndihmës dhe Njoftimin për informacione shtesë për formularin e njoftimit për ndihmën rajonale për përfituesin në ZZHTI Shkup 2, për Shoqërinë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup

nr. 10-73 të datës 05.05.2023 (në tekstin e mëtejshëm: njoftimet), Propozim-Marrëveshjen për ndarjen e ndihmës shtetërore ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup (e nënshkruar, në tekstin e mëtejshëm: Propozim-Marrëveshja), Vendimin për dhënien e pëlqimit nr. 02-729/4 të datës 25.04.2023 të Marrëveshjes për ndarjen e ndihmës shtetërore ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, të miratuar në seancën e njëqind e tridhjetë e gjashtë të Këshillit Drejtues të Drejtorisë për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial, të mbajtur përmes platformës online ZOOM më datë 25.04.2023, Letrën e synimit nr. 13-205/1 të datës 26.01.2022 dhe Planin e Biznesit nr. 13-205/4 të datës 09.11.2022.

Duke marrë parasysh faktin se njoftimet e dorëzuara përmbajnë të dhënat e nevojshme për vlerësimin e ndihmës sipas nenit 14 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, data e pranimit të njoftimit të rregullt konsiderohet 05.05.2023.

KMK, brenda afatit ligjor, shqyrtoi njoftimet e dorëzuara dhe Propozim-Marrëveshjen dhe konstatoi gjendjen faktike si vijon:

- **Dhënësi i ndihmës shtetërore është** Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial.
- **Përfituesi i ndihmës shtetërore është** Shoqëria Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup me seli në adresën: Rr. „Pero Nakov“, nr.124 Shkup, Gazi Babë, Republika e Maqedonisë së Veriut.
- **Baza ligjore për ndarjen e ndihmës shtetërore** është akti juridik në bazë të të cilit ndahet ndihma – Vendimi i Këshillit Drejtues të Drejtorisë për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial nr. 02-729/4 i datës 25.04.2023 për dhënien e pëlqimit të Marrëveshjes për ndarjen e ndihmës shtetërore ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup dhe Propozim-Marrëveshja për ndarjen e ndihmës shtetërore ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup.

Për të konstatuar nëse një masë e ndërmarrë nga dhënësi i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore, vlerësohet nëse plotësohen në mënyrë kumulative katër kriteret e mëposhtme:

- Që masa e tillë të përfshijë transferin e mjeteve shtetërore;
- Të jetë selektive;
- Të përbëjë avantazh ekonomik për marrësin dhe
- Të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti.

Prandaj, gjatë shqyrtimit të masës së përfshirë në njoftimet e dorëzuara, KMK e analizoi atë nga aspekti i plotësimit të katër kriterëve kumulative të lartpërmendura. Gjatë kësaj analize, KMK konstatoi se:

- Masa: **Ndihmë në formën e grantit ose formë tjetër të ndihmës shtetërore që do të nënkuptojë përdorimin e objektit me qira në kushte më të ulëta se çmimi i tregut në vlerë prej 35% të qirasë vjetore të ndërtesës për një periudhë deri në 10 vjet duke filluar nga data e fillimit, vetëm nëse pagesa e qirasë është bërë në kushte dhe çmim real të tregut të aplikueshëm për lizingun financiar të ndërtesës.**

e parashikuar në nenin 4 të Propozim-Marrëveshjes, **përbën ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore për shkak të faktit se ajo plotëson kushtet kumulative të mëposhtme:

- Masa e tillë përfshin transferin e mjeteve shtetërore për shkak të faktit se mjetet ndahen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup;
- Selektiviteti i masës shihet në faktin se ndihma është e destinuar vetëm për një ndërmarrje specifike – Shoqërinë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, gjë që çon në prishjen e ekuilibrit midis ndërmarrjes dhe konkurrentëve të saj. Kështu, selektiviteti i masës shihet edhe në faktin se me ndarjen e ndihmës shtetërore për një ndërmarrje, në rastin konkret për Shoqërinë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, ndërmarrjet e tjera që ekzistojnë dhe veprojnë në të njëjtin treg për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore vihen në një pozitë të disfavorshme. Në këtë mënyrë, me ndarjen e ndihmës shtetërore për këtë masë, Shoqëria Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup gjendet në një pozicion selektiv, duke marrë parasysh faktin se këto mjete mund t'i përdorë në mënyrën më të favorshme për të, me qëllim arritjen e një fitimi më të madh;
- Avantazhi ekonomik për përfituesin shihet në favorizimin e një ndërmarrjeje specifike – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA **Shkup** dhe prodhimit të saj të lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore, avantazh të cilin kjo ndërmarrje nuk do ta kishte në kushte normale tregu dhe biznesi;
- Ndihma e tillë ka ose mund të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti. Kështu, nga dhënia e kësaj mase qartë shihet se përfituesi është i përfshirë në aktivitet ekonomik dhe se do të operojë në tregun ku veprojnë edhe konkurrentë të tjerë, gjë që prish ose mund të prishë konkurrencën duke i mundësuar një avantazh ekonomik ndërmarrjes specifike – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup.

KMK, përveç se konstatoi se masa e lartpërmendur përbën ndihmë shtetërore, gjithashtu konstatoi se një masë e tillë e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore, përbën **ndihmë rajonale** sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 e Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi është në përputhje me qëllimet e politikës rajonale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për **mbështetjen e investimeve fillestare produktive ose krijimin e vendeve të punës të lidhura me investimet.**

KMK gjithashtu konstatoi se masa e lartpërmendur përbën ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 e Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi nuk është ndihmë shtetërore që ndahet në bazë të një skeme ndihme, por është me detyrim për miratim shtesë nga KMK.

KMK, gjatë vlerësimit të lejuarshmërisë së ndarjes së ndihmës, konstaton nëse ndarja e ndihmës bëhet në përputhje me Rregulloren për Përcaktimin e Kushteve dhe Procedurës për Ndarjen e Ndihmës Rajonale.

Në Propozim-Marrëveshje është theksuar se ndryshimi midis qirasë vjetore të paguar dhe ndihmës shtetërore nga paragrafi 4.1 i Propozim-Marrëveshjes për ndarjen e ndihmës shtetërore ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup konsiderohet kosto neto e qirasë për raportimin e shpenzimeve investuese të justifikuara. Ndryshimi midis çmimit të tregut dhe çmimit të reduktuar të qirasë do të konsiderohet ndihmë shtetërore.

– Masa: **Ndihmë në vlerë prej 10% të shumës së shpenzimeve investuese të justifikuara të realizuara deri në datën e përfundimit, e cila do të paguhet me këste si vijon:**

–

- rata e parë në vlerë prej 436.118 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2024, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2024;
- rata e dytë në vlerë prej 287.064 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2025, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2025;
- rata e tretë në vlerë prej 288.017 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2026, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2026;
- rata e katërt në vlerë prej 288.977 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2027, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2027;
- rata e pestë në vlerë prej 298.945 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2028, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2028;
- rata e gjashtë në vlerë prej 290.919 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2029, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2029;
- rata e shtatë në vlerë prej 291.901 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2030, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2030;
- rata e tetë në vlerë prej 292.890 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2031, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2031 dhe
- rata e nëntë në vlerë prej 243.887 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2032, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2032.

e parashikuar në nenin 5 të Propozim-Marrëveshjes, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore për shkak të faktit se ajo plotëson kushtet kumulative të mëposhtme:

- Masa e tillë përfshin transferin e mjeteve shtetërore për shkak të faktit se mjetet ndahen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup;
- **Selektiviteti** i masës shihet në faktin se ndihma është e destinuar vetëm për një ndërmarrje specifike – Shoqërinë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, gjë që çon në prishjen e ekuilibrit midis ndërmarrjes dhe

konkurentëve të saj. Kështu, selektiviteti i masës shihet edhe në faktin se me ndarjen e ndihmës shtetërore për një ndërmarrje, në rastin konkret për Shoqërinë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, ndërmarrjet e tjera që ekzistojnë dhe veprojnë në të njëjtin treg për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore vihen në një pozitë të disfavorshme. Në këtë mënyrë, me ndarjen e ndihmës shtetërore për këtë masë, Shoqëria Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup gjendet në një pozicion selektiv, duke marrë parasysh faktin se këto mjete mund t'i përdorë në mënyrën më të favorshme për të, me qëllim arritjen e një fitimi më të madh;

- Avantazhi ekonomik për përfituesin shihet në favorizimin e një ndërmarrjeje specifike – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup dhe prodhimit të saj të lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore, avantazh të cilin kjo ndërmarrje nuk do ta kishte në kushte normale tregu dhe biznesi;
- Ndihma e tillë ka ose mund të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti. Kështu, nga dhënia e kësaj masë qartë shihet se përfituesi është i përfshirë në aktivitet ekonomik dhe se do të operojë në tregun ku veprojnë edhe konkurrentë të tjerë, gjë që prish ose mund të prishë konkurrencën duke i mundësuar një avantazh ekonomik ndërmarrjes specifike – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup.

KMK, përveç se konstatoi se masa e lartpërmendur përbën ndihmë shtetërore, gjithashtu konstatoi se një masë e tillë e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore, përbën **ndihmë rajonale** sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 e Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi është në përputhje me qëllimet e politikës rajonale të Republikës së Maqedonisë së Veriut **për mbështetjen e investimeve fillestare produktive ose krijimin e vendeve të punës të lidhura me investimet.**

KMK gjithashtu konstatoi se masa e lartpërmendur përbën ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 e Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi nuk është ndihmë shtetërore që ndahet në bazë të një skeme ndihme, por është me detyrim për miratim shtesë nga KMK.

KMK, gjatë vlerësimit të lejuarshmërisë së ndarjes së ndihmës, konstaton nëse ndarja e ndihmës bëhet në përputhje me Rregulloren për Përcaktimin e Kushteve dhe Procedurës për Ndarjen e Ndihmës Rajonale.

Në Propozim-Marrëveshje është theksuar se ndihma shtetërore për çdo kësht do të jetë 10% e shpenzimeve investuese të justifikuar të realizuara deri në datën e përfundimit. Nëse deri në datën e përfundimit, shuma totale e ndihmës shtetërore është më e ulët se 10% e shpenzimeve investuese të justifikuar të konfirmuara të realizuara deri në datën e përfundimit të rishikuar në përputhje me nenin 8 të Propozim-Marrëveshjes, diferenca do të paguhet në një tranxhë shtesë më së voni brenda 60 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për pagesë. Përfituesi i ndihmës shtetërore do ta dorëzojë kërkesën për këtë tranxhë shtesë në një periudhë prej jo më shumë se 30 ditësh nga raporti i auditimit i raportit përfundimtar për shpenzimet investuese të justifikuar, në përputhje me nenin 8 të Propozim-Marrëveshjes.

Në Propozim-Marrëveshje është theksuar se kjo ndihmë shtetërore do të paguhet në kundërvlerë denari, duke aplikuar kursin mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e paraqitjes së kërkesës nga përfituesi i ndihmës shtetërore.

- Masa: Ndhimë shtesë në vlerë prej 10% të shumës së shpenzimeve investuese të justifikuara të realizuara deri në datën e përfundimit, e cila do të paguhet me këste si vijon:
 - rata e parë në vlerë prej 436.118 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2024, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2024, duke konfirmuar se në vitin 2023 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2020, 2021 dhe 2022);
 - rata e dytë në vlerë prej 287.064 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2025, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2025, duke konfirmuar se në vitin 2024 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2021, 2022 dhe 2023);
 - rata e tretë në vlerë prej 288.017 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2026, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2026, duke konfirmuar se në vitin 2025 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2022, 2023 dhe 2024);
 - rata e katërt në vlerë prej 288.977 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2027, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2027, duke konfirmuar se në vitin 2026 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2023, 2024 dhe 2025);
 - rata e pestë në vlerë prej 298.945 euro e cila do të paguhet më së voni deri më 30.12.2028, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2028, duke konfirmuar se në vitin 2027 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2024, 2025 dhe 2026);
 - rata e gjashtë në vlerë prej 290.919 euro do të paguhet më së voni deri më 30.12.2029, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2029, duke konfirmuar se në vitin 2028 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2025, 2026 dhe 2027);
 - rata e shtatë në vlerë prej 291.901 euro do të paguhet më së voni deri më 30.12.2030, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2030, duke konfirmuar se në vitin 2029 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2026, 2027 dhe 2028);
 - rata e tetë në vlerë prej 292.890 euro do të paguhet më së voni deri më 30.12.2031, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2031, duke konfirmuar se në vitin

2030 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2027, 2028 dhe 2029) dhe

- **rata e nëntë në vlerë prej 243.887 euro do të paguhet më së voni deri më 30.12.2032, vetëm nëse përfituesi i ndihmës shtetërore dorëzon kërkesë dhe prova tek dhënësi i ndihmës shtetërore më së voni deri më 30.09.2032, duke konfirmuar se në vitin 2031 përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet për të paktën 5% në raport me mesataren e tre viteve të fundit (2028, 2029 dhe 2030).**

e parashikuar në nenin 5 të Propozim-Marrëveshjes, përbën **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, për shkak të faktit se ajo plotëson kushtet kumulative të mëposhtme:

- Masa e tillë përfshin transferin e mjeteve shtetërore për shkak të faktit se mjetet ndahen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup;
- **Selektiviteti** i masës shihet në faktin se ndihma është e destinuar vetëm për një ndërmarrje specifike – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, gjë që çon në prishjen e ekuilibrit midis ndërmarrjes dhe konkurrentëve të saj. Kështu, selektiviteti i masës shihet edhe në faktin se me ndarjen e ndihmës shtetërore për një ndërmarrje, në rastin konkret për Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, ndërmarrjet e tjera që ekzistojnë dhe veprojnë në të njëjtin treg për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore vihen në një pozitë të disfavorshme. Në këtë mënyrë, me ndarjen e ndihmës shtetërore për këtë masë, Shoqëria Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup gjendet në një pozicion selektiv, duke marrë parasysh faktin se këto mjete mund t'i përdorë në mënyrën më të favorshme për të, me qëllim arritjen e një fitimi më të madh.
- Avantazhi ekonomik për përfituesin shihet në favorizimin e një ndërmarrjeje specifike – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup dhe prodhimit të saj të lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore, avantazh të cilin kjo ndërmarrje nuk do ta kishte në kushte normale tregu dhe biznesi.
- Ndhima e tillë ka ose mund të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti. Kështu, nga dhënia e kësaj masë qartë shihet se përfituesi është i përfshirë në aktivitet ekonomik dhe se do të operojë në tregun ku veprojnë edhe konkurrentë të tjerë, gjë që prish ose mund të prishë konkurrencën duke i mundësuar një avantazh ekonomik ndërmarrjes specifike – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup.

KMK, përveç se konstatoi se masa e lartpërmendur përbën **ndihmë shtetërore**, gjithashtu konstatoi se një masë e tillë e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore, përbën **ndihmë rajonale** sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, pasi është në përputhje me qëllimet e politikës rajonale të Republikës së Maqedonisë së Veriut **për mbështetjen e investimeve fillestare produktive ose krijimin e vendeve të punës të lidhura me investimet.**

KMK gjithashtu konstatoi se masa e lartpërmendur përbën **ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, pasi nuk është ndihmë shtetërore që ndahet në bazë të një skeme ndihme, por është me detyrim për miratim shtesë nga KMK.

KMK, gjatë vlerësimit të lejuarshmërisë së ndarjes së ndihmës, konstaton nëse ndarja e ndihmës bëhet në përputhje me Rregulloren për Përcaktimin e Kushteve dhe Procedurës për Ndarjen e Ndihmës Rajonale.

Në Propozim-Marrëveshje është theksuar se ndihma shtetërore për çdo kësht do të jetë 10% e shpenzimeve investuese të justifikuara të realizuara në periudhën deri në datën e përfundimit. Nëse deri në datën e përfundimit, shuma totale e ndihmës shtetërore është më e ulët se **10%** e shpenzimeve investuese të justifikuara të konfirmuara të realizuara deri në datën e përfundimit të rishikuar në përputhje me Nenin 8 të Propozim-Marrëveshjes, diferenca do të paguhet në një tranxhë shtesë më së voni brenda 60 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për pagesë dhe nëse përfituesi i ndihmës shtetërore ka rritur të ardhurat nga shitjet në vitin kalendarik të fundit deri në datën e përfundimit për të paktën 5% (pesë për qind) krahasuar me mesataren e tre viteve të fundit. Përfituesi i ndihmës shtetërore do ta dorëzojë kërkesën për këtë tranxhë shtesë në një periudhë prej jo më shumë se 30 ditësh nga raporti i auditimit i raportit përfundimtar për shpenzimet investuese të justifikuara në përputhje me Nenin 8 të Propozim-Marrëveshjes.

Në Propozim-Marrëveshje është theksuar se kjo **ndihmë shtetërore** do të paguhet në **kundërvlerë denari**, me aplikimin e kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e paraqitjes së kërkesës nga përfituesi i ndihmës shtetërore.

- Masa: **Ndihmë për krijimin e vendeve të reja të punës për punonjës të rinj, të punësuar me orar të plotë deri në datën e përfundimit të projektit investues, si vazhdim i numrit të punonjësve prej 350 punonjësve aktualisht të punësuar tek përfituesi i ndihmës shtetërore, në vlerë prej 3.000 euro për një vend pune në kundërvlerë denari sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e paraqitjes së kërkesës nga përfituesi i ndihmës shtetërore.**

e parashikuar në nenin 7 të Propozim-Marrëveshjes, përbën **ndihmë shtetërore**, në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, për shkak të faktit se ajo plotëson kushtet kumulative të mëposhtme:

- Masa e tillë përfshin transferin e mjeteve shtetërore për shkak të faktit se mjetet ndahen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup;
- **Selektiviteti** i masës shihet në faktin se ndihma është e destinuar vetëm për një ndërmarrje specifike – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, gjë që çon në prishjen e ekuilibrit midis ndërmarrjes dhe konkurrentëve të saj. Kështu, selektiviteti i masës shihet edhe në faktin se me ndarjen e ndihmës shtetërore për një ndërmarrje, në rastin konkret – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, ndërmarrjet e tjera që ekzistojnë dhe veprojnë në të njëjtin treg për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore vihen në një pozitë të disfavorshme. Në këtë mënyrë, me ndarjen e ndihmës shtetërore për këtë masë, Shoqëria Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup gjendet në një pozicion selektiv, duke marrë parasysh faktin se këto mjete mund t'i përdorë në mënyrën më të favorshme për të, me qëllim arritjen e një fitimi më të madh.
- Avantazhi ekonomik për përfituesin shihet në favorizimin e një ndërmarrjeje specifike – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA

Shkup dhe prodhimit të saj të lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore, avantazh të cilin kjo ndërmarrje nuk do ta kishte në kushte normale tregu dhe biznesi.

- Ndihma e tillë ka ose mund të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti. Kështu, nga dhënia e kësaj masë qartë shihet se përfituesi është i përfshirë në aktivitet ekonomik dhe se do të operojë në tregun ku veprojnë edhe konkurrentë të tjerë, gjë që prish ose mund të prishë konkurrencën duke i mundësuar një avantazh ekonomik ndërmarrjes specifike – Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup.

KMK, përveç se konstatoi se masa e lartpërmendur përbën ndihmë shtetërore, gjithashtu konstatoi se një masë e tillë e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore, përbën **ndihmë rajonale** sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 e Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi është në përputhje me qëllimet e politikës rajonale të Republikës së Maqedonisë së Veriut **për mbështetjen e investimeve fillestare produktive ose krijimin e vendeve të punës të lidhura me investimet.**

KMK gjithashtu konstatoi se masa e lartpërmendur përbën **ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 e Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi nuk është ndihmë shtetërore që ndahet në bazë të një skeme ndihme, por është me detyrim për miratim shtesë nga KMK.

KMK, gjatë vlerësimit të lejuarshmërisë së ndarjes së ndihmës, konstaton nëse ndarja e ndihmës bëhet në përputhje me Rregulloren për Përcaktimin e Kushteve dhe Procedurës për Ndarjen e Ndihmës Rajonale.

Në Propozim-Marrëveshje është theksuar se përfituesi i ndihmës shtetërore do të sigurojë ndihmë shtetërore për përfituesin e ndihmës shtetërore për krijimin e vendeve të reja të punës për projektin investues, për punonjës të rinj me kontratë punësimi me kohë të plotë, ku krijimi i vendeve të punës nënkupton një rritje neto të numrit të punonjësve të punësuar direkt nga përfituesi i ndihmës shtetërore në krahasim me mesataren në 12 muajt e mëparshëm. Çdo vend pune i humbur në atë periudhë 12-mujore do të zbritet nga numri i vendeve të punës të krijuara në të njëjtën periudhë.

Në Propozim-Marrëveshje është theksuar se **ndihma shtetërore** për krijimin e vendeve të reja të punës do të paguhet nga dhënësi i ndihmës shtetërore për përfituesin e ndihmës shtetërore për vendet e reja të punës të krijuara në periudhën deri në datën e përfundimit, vetëm nëse niveli dhe norma e rritjes së pagave bruto mujore bazë janë të barabarta ose tejkalojnë dinamikën e rritjes siç është projektuar në Planin e Biznesit nr. 13-205/4 të datës 09.11.2022.

Gjithashtu, në Propozim-Marrëveshje është theksuar se përfituesi i ndihmës shtetërore do të krijojë 53 vende të reja pune duke punësuar të paktën 53 punonjës të rinj deri në datën e përfundimit, me të cilët do të lidhë kontratë për nevojat e projektit investues duke filluar nga data e lëshimit të Vendimit për fillimin e punës, si vazhdim i numrit të punonjësve mbi 350 aktualisht të punësuar nga përfituesi i ndihmës shtetërore.

Përveç kësaj, në Propozim-Marrëveshje është theksuar se përfituesi i ndihmës do të mbajë investimin, pra asetet (objektet, ndërtesat, pajisjet) në zonë në gjendje produktive, operationale dhe të përdorshme për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh nga data e përfundimit të projektit investues, gjë që është në përputhje me nenin 6 (1) të Rregullores për Kushtet dhe Procedurën për Ndarjen e Ndihmës Rajonale. Nëse përfituesi i ndihmës shtetërore nuk e

plotëson këtë kusht, ai është i detyruar të kthejë shumën e plotë të ndihmës shtetërore të marrë sipas Marrëveshjes për Ndarjen e Ndihmës Shtetërore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Shoqërisë Aksionare për prodhimin e pajisjeve të frenimit VABTEK MZT SHA Shkup së bashku me normën e interesit të llogaritur në përputhje me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore dhe bazuar në normën referencë për llogaritjen e normës së interesit të publikuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përfituesi i ndihmës shtetërore do të financojë të paktën 25% të shpenzimeve investuese të justifikuara për projektin investues nga burime vetjake ose nga një palë e tretë në formë që nuk përbën ndihmë shtetërore sipas Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore.

Përfituesi i ndihmës shtetërore do të sigurojë të gjitha asetet për realizimin e projektit investues në zonë nga rreziqet që rrjedhin nga operacionet. Përfituesi i ndihmës shtetërore do të sigurojë asetet që janë objekt i ndihmës shtetërore për kohëzgjatjen e investimit dhe 5 vjet pas datës së përfundimit.

Përfituesi i ndihmës shtetërore detyrohet të mos zvogëlojë numrin e vendeve të punës të krijuara para realizimit të projektit investues në zonë, për një periudhë kohore të barabartë me periudhën e qëndrueshmërisë së investimit të ri në ZZHTI Shkup 2.

Për shpërndarjen e saktë të ndihmës shtetërore, në raportet vjetore jepet një pasqyrë e të gjithë punonjësve, duke përfshirë edhe ata që ishin punësuar para vendimit për fillimin e punës, dhe veçmas për punonjësit e rinj, së bashku me llogaritjen e shumës së tatimit personal mbi të ardhurat bazuar në pagat e paguara për punonjësit, punonjësit e punësuar para vendimit për fillimin e punës dhe veçmas për punonjësit e rinj, të punësuar për projektin investues siç është përcaktuar me Propozim-Marrëveshjen.

Përfituesi i ndihmës shtetërore detyrohet të mbajë numrin total të vendeve të reja të punës për të cilat ka marrë ndihmë shtetërore në përputhje me nenin 7 të Propozim-Marrëveshjes për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e përfundimit të projektit investues.

Ndihma shtetërore rajonale kumulative për projektin investues do të kufizohet në një shumë jo më të lartë se 50% e shpenzimeve investuese të justifikuara të konfirmuara të realizuara deri në datën e përfundimit të projektit investues.

Sipas Mendimit të KMK nr. 03-198/4 të datës **29.12.2022**, dhënia e ndihmës shtetërore lejohet vetëm nëse, përveç investimit të ri të planifikuar në ZZHTI Shkup 2, kompania ruan investimin aktual dhe objektin e prodhimit së bashku me të gjithë punonjësit në të njëjtin vëllim si para periudhës së fillimit të investimit të planifikuar në ZZHTI Shkup 2 për një periudhë kohore të barabartë me periudhën e qëndrueshmërisë së investimit të ri të planifikuar në ZZHTI Shkup 2.

Në bazë të sipërpërmendurën, KMK vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshillë juridike: Kundrejt këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë për fillimin e një mosmarrëveshjeje administrative brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit, sipas nenit 26 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit, përveç në rast se Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës do të urdhërojë kthimin e ndihmës shtetërore të paligjshme apo të abuzuar, dhënia e së cilës nuk është e lejuar.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETAR

Prof. Dr. Владимир Наумовски